



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL KORCË

Nr. 274 Prot.

Korcë, më 14.02.2024

U R D H Ë R

Nr. 20, datë 14.02.2024

“PËR KRIJIMIN E BORDIT DREJTUES TË SPITALIT RAJONAL KORCË”

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr.55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 8 të VKM-së nr.36, datë 27.01.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Spitaleve Rajonale, Terciare dhe Qendrave Spitalore Rajonale Publike”; si dhe të shkresës Nr 166/1, datë 05.02.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

U R D H Ë R O J:

- A. Krijimin e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Korcë, të përbërë si më poshtë:
- | | | |
|---------------------|--|----------|
| 1. Entela Ramosaçaj | (Përfaqësues i MSHMS) | Kryetare |
| 2. Arben Asllani | (Përfaqësues i OSHKSH Elbasan) | Anëtar |
| 3. Petrika Tollkuci | (Përfaqësues i FSDKSH Korcë) | Anëtar |
| 4. Kristo Bezhani | (Përfaqësues i Shoqatës së Pacineteve me Diabet) | Anëtar |
| 5. Dr.Gerla Petro | (Përfaqësues i Komisionit Mjekësor SRK) | Anëtar |
- B. Funksionet e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Korcë do të jenë:
- mbikqyr dhe kontrollon drejtimin e veprimtarisë së spitalit;
 - miraton rregulloren e brendshme, rregulloret ekonomike, financiare, të auditimit dhe të kontrollit, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të spitalit, sipas rregullores tip të miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
 - miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin, buxhetin vjetor;
 - miraton përdorimin e të ardhurave dytësore të spitalit, sipas prioriteteve të tij;
 - i propozon për miratim ministrit përgjegjës për shëndetësinë strukturën organizative të spitalit;

- f) miraton indikatorët e performancës së personelit shëndetësor dhe normat e aktivitetit të shërbimit spitalor;
- g) miraton kontratën tip të punës për personelin shëndetësor të spitalit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit;
- h) harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të Bordit;
- i) kontrollon zbatimin e normave dhe aktivitetit mjekësor, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, lidhur me shërbimet përkatëse klinike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: S.Venxha Përgjegjës Sektori të Çështjeve Ligjore

DREJTOR

Litian BROKA

